LIGJ
Nr. 9234, datë 20.5.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB) PËR FINANCIMIN E FAZËS SË DYTË TË PROJEKTIT TË SPITALIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e fazës së dytë të projektit të Spitalit të Përgjithshëm Durrës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4241, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
KREDIE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E FAZËS-II TË PROJEKTIT TË SPITALIT TË PËRGJITHSHËM NË DURRËS

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më 30/01/425 H, e cila i përkon 12/03/2004G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim të quajtur "Kredimarrës") dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim referuar si "Banka"), në të cilën:

A) Kredimarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë për mbulimin e kostos së financimit të fazës II të projektit të Spitalit të Përgjithshëm në Durrës (në vijim të quajtur "Projekti") sipas përshkrimit në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje duke siguruar kredinë e dhënë më poshtë;

B) Një nga qëllimet e Bankës është që të ndihmojë vendet e veta anëtare duke livruar kredi për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore i përligjur;

D) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t'i japë Kredimarrësit kredinë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë;

Për këto arsye, palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizimet, kushtet e përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizimet: Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga kuptimi rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara që jepen si më poshtë vijon:

a) "Disbursim" do të thotë tërheqje e shumës së kredisë.

b) "Procedurë e disbursimit" do të thotë procedurë e disbursimit e Bankës.

c) "Datë e vlefshme" do të thotë data në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Kredimarrësit.

d) "Agjencia zbatuese" do të thotë Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë që është institucioni zbatues përgjegjës për realizimin, drejtimin dhe kontrollin e Projektit ose cilido institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe nga Banka.

e) "Kushte të përgjithshme" do të thotë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për kredi dhe marrëveshje garantuese të Bankës që i përkasin datës 8.11.1976.

f) "Dinari islamik/DI" siç pëkufizohet në nenin 4(1)(a) të Marrëveshjes themeluese të Bankës është njësia për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

g) "Shumë e kredisë" do të thotë shuma për të cilën Banka ka rënë dakord t'ia japë Kredimarrësit në mënyrën e përcaktuar në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.

h) "Agjencia paguese" do të thotë Ministria e Financave e Kredimarrësit.

i) "Shuma themelore" do të thotë shuma në total e kredisë, aktualisht e tërhequr nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje.

j) "Udhëzime të prokurimit" do të thotë udhëzimet për prokurim të mallrave dhe shërbimeve të financuara nga Banka.

k) "Projekti" dhe referime në "pjesë" të tij do të thotë Projekti dhe pjesë të tij, ashtu siç janë përshkruar në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje.

l) "Tarifë e shërbimit" do të thotë tarifa që i paguhet Bankës nga Kredimarrësi ashtu siç përcaktohet në seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha parashikimet e kushteve të përgjithshme si njëlloj të vlefshme dhe efektive, ashtu siç paraqiten në vijim.

Neni 2
Kredia

Seksion 2.01 Shuma e kredisë: Banka bie dakord t'i japë Kredimarrësit kredi nga burimet e veta të zakonshme, ne një shumë që nuk tejkalon barasvlerën e DI 5,420,000 (Dinarë islamikë pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) vetëm sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga Marrëveshja e kredisë, do të prokurohen me anë të procedurave të tenderit Ndërkombëtar (PTN), të kufizuar për vendet anëtare në përputhje me udhëzuesit e prokurimit të Bankës. Për këtë arsye, Kredimarrësi do t'u përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj Izraelit.

Neni 3
Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 3.01 Tërheqja: shuma e kredisë do të tërhiqet nga Kredimarrësi sipas tabelës III dhe parashikimeve të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurës së disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e pranueshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin, për të cilin është rënë dakord sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë:

Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshmerisë ose çdo datë tjetër të mëvonshme siç do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, Kredimarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë të pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Kredimarrësit.

Seksioni 3.03 Data e përfundimit të disbursimit: 31/12/2007 ose një datë e mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga

shuma e kredisë për qëllime të seksionit 6.03 (c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.04 Përdorimi i shumës së kredisë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Kredimarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të Projektit të financuar nga Banka.

Neni 4

Zhvleftësimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 4.01 Zhvleftësimi: Kredimarrësi do të ripaguajë shumën themelore në 25(njëzetë e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë faljeje 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore siç parashikohet në tabelën II (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Tarifa e shërbimit:

a) Kredimarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë shërbimi në një shumë të vlerësuar fillimisht në 422,760 DI (katërqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë dinarë islamikë), sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën II (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga palët në këtë marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, tek e cila referon nënseksioni 4.02 (a), është veçse nje vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë siç është konceptuar këtu. Gjithashtu, bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përllogaritet pas zbatimit të Projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të akumulohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Vendet e pagesave: Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave janë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 4.04 Pa ndonjë paragjykim për tërësinë e parashikimeve të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të gjykohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

a) Nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë:
Llogaria nr. GB14 GULF 4053 0700 1591
Gulf International Bank B.S.C.
London Branch
One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom/Britania e Madhe
SWIFT CODE: GULFGB2L

b) Nëse kjo pagesë është bërë në paund britanikë:
Llogaria nr.122432 GBP2520 01
Gulf International Bank B.S.C.
London Branch
One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom/Britania e Madhe
Tlx. Nr. 8812889/8813326 GIBANK G
SWIFT CODE: GULFGB2L

c) Nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro:
Llogaria nr. 096965 001 51
(Union De Banques Arabes Et Francaises (UBAF)/Bashkimi I Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
Francë
Teleks Nr. 610334 UBAF
SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 5

Zbatimi i projektit

Seksioni 5.01 Kredimarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë Projektin dhe të drejtojë punimet e tij përmes agjencise së zbatimit me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikat e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me eksperiencë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetit, planifikimet dhe specifikimet lidhur me Projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi nga ana e saj të çdo ndryshimi të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specifikimet e Projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash lidhur me zbatimin e Projektit.

Neni 6
Parakushte shtesë përpara disbursimit nga Banka

Kredimarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, duhet të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përsa më sipër.

Neni 7
Klauzola të veçanta

Seksioni 7.01 Kredimarrësi do të ketë gjendje, sapo t'i kërkohet, të gjitha shumat që përfshijnë sasitë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e Projektit sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveç se kur Banka bie dakord ndryshe, Kredimarrësi do të trajtojë të gjitha kontratat që financohen nga vazhdimësia e kësaj kredie për zbatimin e Projektit përmes procedurave ndërkombëtare të tenderit të kufizuar për vendet anëtare të BIZH (IDB) dhe do të kërkojë miratim paraprak nga Banka për shpalljen fituese të çdo kontrate, vlera e të cilës tejkalon shumën ekuivalente prej njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë (DI 150,000).

Seksioni 7.03 Kredimarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të Projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre në një mënyrë të detajuar sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e kredisë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në Projekt, të dokumentojë ecurinë e Projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikat e konsoliduara të kontabilitetit veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Kredimarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akredituar të Bankës me qëllime të lidhur me Projektin, si dhe për të kontrolluar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistër tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së Projektit, mallrave dhe veprimeve si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Kredimarrësi angazhohet, me qëllim për të çuar më tej dhe për të zbatuar Projektin, të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës në përputhje me rregullat dhe udhëzimet si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi, administratë dhe drejtues të përshtatshëm për ecurinë e nevojshme dhe efikase të veprimtarisë së Projektit.

Seksioni 7.07 Kredimarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i kredisë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transit dhe rreziqe të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Kredimarrësit dhe

dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të Projektit dhe do të sigurohen në shuma që janë në përputhje me praktikat tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e kredimarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumat e sigurimit në monedhë lehtësisht të shkëmbyeshme.

Seksioni 7.08 Kredimarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohet si e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të siç kërkohet për realizimin e Projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të Projektit.

Seksioni 7.09 Kredimarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet kur të jetë e nevojshme për të lejuar institucionin zbatues të realizojë Projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që mund të ndalojë, ose ndërhyjë në zbatimin, ose veprimarinë e Projektit, ose në përmbushjen e çdonjërit prej parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Kredimarrësi si çështje konfidenciale.

Neni 8
Raportet

Seksioni 8.01

a) Kredimarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se objektivat e Kredisë do të përmbushen. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar lidhur me gjendjen e përgjithshme të Kredisë. Nga ana e Kredimarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Kredimarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Kredimarrësit.

b) Kredimarrësi dhe Banka në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës palë do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve përkatës përsa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e Kredisë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Kredimarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin ose të ndikojë për dorëzimin në Bankë të secilit nga raportet e mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë afati tjetër që palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e Projektit në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here në mënyrë të detajuar;

ii) raporte të tjera që Banka në mënyrë të arsyetuar do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së kredisë të disbursuar dhe ecurinë e Projektit;

iii) Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një date të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Kredimarrësi dhe Banka, Kredimarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të Projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të noterizohen sipas vullnetit të lirë të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9
Vlefshmëria

Kjo Marrëveshje nuk do të ketë efekte deri sa:

A) (1) Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Kredimarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga të gjitha instancat përkatëse të qeverisjes;

(2) Kredimarrësi do të dorëzojë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën që buron nga autoriteti ligjor i kredimarrësit, duke deklaruar se Marrëveshja e Kredisë është autorizuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur në emër të Kredimarrësit. Deklarata do të shprehë se Marrëveshja përbën një detyrim ligjor për Kredimarrësin sipas kushteve të veta.

B) Një letër autorizimi do të nënshkruhet nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion tjetër i

autorizuar për këtë qëllim nga ana e Kredimarrësit për bankën qendrore ose subjektin që ushtron funksionet e një banke qendrore, se pagesa nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje e shumës themelore dhe këstet e tarifës së shërbimit do të kryhen nga banka qendrore, ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara. Një kopje e letrës së autorizimit së bashku me një vërtetim nga banka qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, e cila demonstron se është marrë letra e autorizimit dhe se do t'i bashkëngjitet udhëzimeve të përfshira në të do t'i dërgohet Bankës nga Kredimarrësi.

Neni 10

Përfundimi i marrëveshjes për moszbatueshmëri

Nëse Marrëveshja nuk zbatohet brenda 12 muajve nga data e nënshkrimit e cituar në të, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveç se kur Banka pas marrjes në konsideratë të të gjitha shkaqeve të vonesës do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka menjëherë do të njoftojë Kredimarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11

Parashikime të ndryshme

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar: Ministri i Financave i Kredimarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Kredimarrësit për qëllime të Seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa: Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë-Shqipëri.
Tel./Fax.: ++355 4 228-494

Për Bankën Islamike për Zhvillim:
P.O. Box: 5925
Jeddah 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601137 ISDB SJ
Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH
Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, secili duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më lart.

TABELA I
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i Projektit është të ndihmojë popullsinë e Durrësit dhe zonave përrreth me një shërbim shëndetësor të përparuar. Kjo mund të realizohet edhe duke shtuar një infrastrukturë prej 160 shtretër, meqenëse realizimi i kësaj është parashikuar në master planin fillestar për këtë spital rajonal me kapacitet prej 400 shtretër. Kështu pra, do të realizohen nevojat e qytetit dhe zonave përreth.

Zbatimi i Projektit përfshin aktivitetet e mëposhtme:

i) Punimet civile;
ii) konsulencën;
iii) njësinë e menaxhimit të Projektit;
iv) shërbimin e auditimit dhe
v) pajisjet dhe orenditë mjekësore.

TABELA II (A)
RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE

Shteti: Republika e Shqipërisë
Projekti: Faza-II e Spitalit të Përgjithshëm në Durrës
Shuma e Kredisë: DI. 5,420,000/-
Periudha e Kredisë: 25 vjet.
Periudha e faljes: 7 vjet.
Tarifa e shërbimit: 422,760 DI.

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06. 2011	150,555
2	31.12. 2011	150,555
3	30.06. 2012	150,555
4	31.12. 2012	150,555
5	30.06. 2013	150,555
6	31.12. 2013	150,555
7	30.06. 2014	150,555
8	31.12. 2014	150,555
9	30.06. 2015	150,555
10	31.12. 2015	150,555
11	30.06. 2016	150,555
12	31.12. 2016	150,555
13	30.06. 2017	150,555
14	31.12. 2017	150,555
15	30.06. 2018	150,555
16	31.12. 2018	150,555
17	30.06. 2019	150,555
18	31.12. 2019	150,555
19	30.06. 2020	150,555
20	31.12. 2020	150,555
21	30.06. 2021	150,555
22	31.12. 2021	150,555
23	30.06. 2022	150,555
24	31.12. 2022	150,555
25	30.06. 2023	150,555
26	31.12. 2023	150,555
27	30.06. 2024	150,555
28	31.12. 2024	150,555
29	30.06. 2025	150,555
30	31.12. 2025	150,555
31	30.06. 2026	150,555
32	31.12. 2026	150,555
33	30.06. 2027	150,555
34	31.12. 2027	150,555
35	30.06. 2028	150,555
36	31.12. 2028	150,560
Totali:		5,420,000

TABELA II (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti: Republika e Shqipërisë
Projekti: Faza-II e Spitalit të Përgjithshëm në Durrës
Shuma e Kredisë: DI. 5,420,000/-

Periudha e Kredisë: 25 vjet.
Periudha e faljes: 7 vjet.
Tarifa e shërbimit: 422,760 DI.

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06.2004	16,900
2	31.12.2004	33,821
3	30.06.2005	33,821
4	31.12.2005	33,821
5	30.06.2006	33,821
6	31.12.2006	33,821
7	30.06.2007	23,675
8	31.12.2007	23,675
9	30.06.2008	23,675
10	31.12.2008	23,675
11	30.06.2009	23,675
12	31.12.2009	23,675
13	30.06.2010	23,675
14	31.12.2010	23,675
15	30.06.2011	23,675
16	31.12.2011	23,675
Totali:		422,760

TËRHEQJE NGA TË ARDHURAT E KREDISË

1. Shuma e Kredisë prej DI.5,420,000/- (pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) do të përdoret për të mbuluar kostot e zërave të mëposhtëm:

US$ milion

Përshkrimi i komponentëve	Qeveria Shqiptare				IDB		Totali i secilit Komponent	
	Amount	%	F/C	L/C	Amount	%	Amount	%
Punime civile (Ndërtim)	-	0	2.683	3.059	5.742	100	5.742	100
Shërbime konsulence (Proj,Super.)	-	0	0.460	-	0.460	100	0.460	100
Njësia e menaxhimit të projektit (PMU)	0.090	49	0.012	0.081	0.093	51	0.183	100
Pajisje dhe orendi mjekësore	0.980	100	-	-	-	0	0.980	100
Shërbime auditimi	-	0	-	0.090	0.090	100	0.090	100
Workshope dhe vizitë familjarizimi në IDB HQ	-	0	0.010	0.010	0.020	100	0.020	100
Sub-total	1.070	14	3.165	3.240	6.405	86	7.475	100
Rezervë si të paparashikuara	0.107	14	0.317	0.324	0.641	86	0.748	100
Total	1.177	14	3.482	3.564	7.046	86	8.223	100

2. Shumat e shpërndara në këtë tabelë janë vlerësime paraprake. Shumat përfundimtare do të përcaktohen

gjatë zbatimit të Projektit në përputhje me kostot aktuale brenda shumës së kredisë.

ID429 - Shqipëria - mhk